

VENDIM
Nr. 365, datë 20.5.2026

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË
ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË
OBJEKT KONCESIONI, ME VENDNDODHJE NË ZONAT KADASTRALE 3572, 3584
DHE 3619, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE TËRPAN, BASHKIA POLIÇAN, QARKU
BERAT, NGA SHOQËRIA “X ONE” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në zonat kadastrale 3572, 3584 dhe 3619, në Njësinë Administrative Tërpan, Bashkia Poliçan, qarku Berat, nga shoqëria “X ONE” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: shoqëria “X ONE” sh.p.k.;
- b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: M17925505T;
- c) Tipi i centralit: fotovoltaik;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 54 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në zonat kadastrale 3572, 3584 dhe 3619, në Njësinë Administrative Tërpan, Bashkia Poliçan, qarku Berat;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës dhe planvendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) Shoqëria “X ONE” sh.p.k., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht, çdo tre muaj, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “X ONE” sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) %, të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "X ONE" sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Albana Koçiu

ANEKS 1

CENTRALI GJENERUES I ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONAT KADASTRALE NR. 3572, 3584 DHE 3619, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE TËRPAN, BASHKIA POLIÇAN, QARKU BERAT, NGA SHOQËRIA "X ONE" SHPK

KRGJSH	X	Y
1	501965.3574	4492751.611
2	501960.917	4492722.489
3	501979.5783	4492713.852
4	502194.885	4492662.331
5	502325.3301	4492613.199
6	502428.1584	4492586.385
7	502572.6912	4492552.267
8	502572.2464	4491991.504
9	502528.5619	4491987.575
10	502391.5767	4491870.009
11	502159.0929	4491613.379
12	502029.7274	4491872.214
13	501936.0775	4492072.428
14	501846.7226	4492262.081
15	501786.785	4492389.794
16	501698.0054	4492674.17

PLAN VENDOSJE

OBJEKTI: X ONE PHOTOVOLTAIC PARK, 54 MW
VENDODHJA : Zona Kadastrale 3572, 3584 dhe 3619, Fshati Teman, Njësia Administrative Tërpan, Bashkia Poliçan, Qarku Berat, Shqipëri.
LLOJI I PASURISË: Kullotë/Fond Kullësor Publik (Pjesë e Ekonomisë Kullësore Mali Tërpan)
PASURIA: Nr. 1890/1 (sipërfaqe 6,400.00 m²), Zona Kadastrale 3572
 Nr. 974/3 (sipërfaqe 240,090.00 m²), Zona Kadastrale 3584
 Nr. 1378/1 (sipërfaqe 353,510.00 m²), Zona Kadastrale 3619
SIPËRFAQJA E PROJEKTIT : 600,000.00 m² (60 ha)
ZHVILLUESI: X ONE sh.p.k
HARTOI: DELTA PLAN STUDIO sh.p.k




DELTA PLAN STUDIO sh.p.k
 Ing. Elektrik Entela PONARI
 Ing. Elektrik Bledi LAME
 Ing. Gjeodet Ermir STAFSULA

LICENCE N. 7039/5
 LICENCE E. 1558/2
 LICENCE E. 1175/2
 LICENCE T. 1502

Entela
 Ponari
 Ermir

Bledi
 Lame



X ONE SHPK
 (NUS) M17925505T
 TIRANË

SHKALLA 1:25000

Sip = 600000m2

KORDINATAT NE KRGJSH

NR	E	N	NR	E	N	NR	E	N	NR	E	N
1	501965.3574	4492751.611	5	502325.3301	4492613.799	9	502528.5619	4491987.575	13	501936.0775	4492072.428
2	501960.917	4492722.489	6	502428.1584	4492586.385	10	502391.5767	4491870.009	14	501846.7226	4492262.081
3	501979.5783	4492713.852	7	502572.6912	4492552.267	11	502159.0929	4491613.379	15	501786.785	4492389.794
4	502194.885	4492662.331	8	502572.2464	4491991.504	12	502029.7274	4491872.214	16	501698.0054	4492674.17